



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. 32/19
Datë: 21.08.2019

Në mbështetje të nenit 23 par.1 dhe 2, neni 28 paragrafi 1 pika 1.7, pika 1.10 dhe pika 1.11, neni 29 LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS si dhe Ligji për plotësim ndryshim i tij Nr. 04/L-226, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përbërje të: Valon Prestreshi - Kryetar, Fatime Haziri - Komisionere, Shaqir Morina Komisioner, Muhamed Krasniqi – Komisioner, lidhur me kërkesën nga Organi Shqyrtues i Prokurimit – OSHP, mbi procesin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të IT-së” të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP, në mbledhjen e mbajtur me datën 21.08.2019 jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatore** në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkuruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.
- III. Duke pasur parasysh që prokurimi publik financohet me paratë e taksapaguesve, të gjithë operatorëve ekonomik duhet tu mundesohet të marrin pjesë duke paraqitur oferta dhe/ose propozime për kërkesat për të cilat ata janë të kualifikuar. Për më tepër, kërkesat e prokurimit publik duhet të shpërndahen gjerësisht për të rritur shanset për një reagim të mirë të tregut.
- IV. Ndërveprimi midis politikave të konkurrencës dhe prokurimit publik është një domosdoshmëri. Ato prekin njëra-tjetren për nevojën për të trajtuar praktikant antikonkurrese ose manipulimin e ofertave në tenderët publik.

- V. Autoriteti thekson se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t'u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës.
- VI. Autoriteti vlerëson se OSHP gjatë marrjes së vendimeve dhe Autoritetet Kontraktuese gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit të sigurojnë që operatorët të mos kufizohen nëpërmjet kushteve dhe kriterëve diskriminuese/përrjashtuese. Kufizimet e tilla mund të qojnë në favor të një operatori të veçant duke i vendosur në pozita të pafavorshme konkurruese operatorët tjerë. Sigurimi i konkurrencës efikase në prokurimin publik, do t'i mundësonte ndërmarrjeve të konkurrojnë me ofertën e tyre e cila në fund, do të jetë në favor të shfrytëzuesve/përdoruesve përfundimtar të cilët do të jenë në gjendje të zgjedhin ofertën më të përshtatshme për ta midis produkteve/operatorëve të ndryshem.
- VII. Autoriteti jep këtë mendim profesional duke e trajtuar kërkesën vetëm nga aspekti i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**


 Valon Prestreshi
 Kryetar

() Ahmet Krasniqi
 Zv. Kryetar

() Fatime Haziri
 Komisionere

() Muhamed Krasniqi
 Komisioner

() Shaqir Morina
 Komisioner

Me këtë Mendim Profesional të njoftohet:

- OSHP-ja
- Arkivi